

**SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA SH.A.**

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016  
të përgatitura sipas  
Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**

## Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur.....	i
Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Paqyra e ndryshimeve në kapital.....	3
Paqyra e flukseve të parasë.....	4
1. Të përgjithshme.....	5
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël.....	5
3. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël.....	12
4. Vlera e drejtë.....	12
5. Adoptimi i standarteve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara.....	13
6. standardet dhe interpretimet e reja.....	14
7. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit.....	16
8. mjete monetare.....	23
9. Depozita me afat.....	23
10. Investime në letra me vlerë.....	24
11. Investime në filiale.....	24
12. Kosto të shtyra të marrjes në sigurim.....	25
13. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera.....	25
14. Aktive afatgjata materiale.....	26
15. Rezervat për kontratat e sigurimit dhe aktivet nga risigurimi.....	26
16. Llogari të pagueshme për risigurimin.....	27
17. Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera.....	27
18. Kapitali aksionar.....	28
19. Primet e shkruara bruto.....	28
20. Te ardhurat nga interesi.....	28
21. Kostot e marrjes në sigurim.....	28
22. Shpenzime administrative.....	29
23. Shpenzime të tjera operative.....	29
24. Tatim fitimi.....	29
25. Detyrime dhe të drejta të kushtëzuara dhe angazhime.....	30
26. Transaksionet me palët e lidhura.....	30
27. Ngjarjet pas datës së raportimit.....	30
I) Aftësia paguese.....	i
II) Aktivët në mbulim të provigjioneve teknike dhe matematikore.....	ii



## Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.

### Raporti mbi auditimin e pasqyrave financiare

#### Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016;
- pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

#### Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

#### Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

#### Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

#### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Rr. Ibrahim Rugova, SkyTower, kati 9, Tiranë, Shqipëri  
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, [www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al)



## Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një prishmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

## Raporti mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e raporteve shtesë në lidhje me aftësinë paguese dhe aktivet në mbulim të progjioneve teknike dhe matematikore në përputhje me rregulloret e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"). Këto raporte nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Informacioni historik që paraqitet në këto raporte është i krahasueshëm me shumat e paraqitura në pasqyrat financiare.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k


PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k  
4 maj 2017  
Tiranë, Shqipëri

Jonid Lamllari  
Auditues Ligjor

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>AKTIVET</b>			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	8	33,563	32,235
Depozita me afat	9	751,642	907,791
Investime në letra me vlerë	10	889,251	728,688
Investime në filiale	11	11,232	11,232
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	183,053	241,337
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi e të tjera	13	27,460	30,299
Aktive të risigurimit		9,286	6,558
Tatim fitimi i parapaguar		9,318	-
Inventarë		335	441
Aktive afatgjata materiale	14	17,126	17,783
Aktive afatgjata jo materiale		4,020	4,020
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>1,936,286</b>	<b>1,980,384</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrimet për humbjen dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	15	869,688	778,242
Rezerva për primin e pafitur	15	386,389	433,288
Tatimi mbi fitimin për t'u paguar		0	13,174
Llogari të pagueshme për risigurimin	16	3,531	3,356
Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera	17	24,725	30,006
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>1,284,333</b>	<b>1,258,066</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar	18	370,000	370,000
Rezerva e sigurisë	18	150,749	150,749
Fitime të pashpërndara		131,204	201,569
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>651,953</b>	<b>722,318</b>
<b>TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE</b>		<b>1,936,286</b>	<b>1,980,384</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më 28 prill 2017 dhe janë firmosur në emër të tyre nga:

  
Edvin Hoxhaj  
Drejtor i Përgjithshëm

  
Edmira Madani  
Drejtoresh e Financës

**PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA  
GJITHËPËRFSHIRËSE**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga primet e shkruara bruto	19	586,647	675,726
Prime të shkruara ceduar risiguruesit		(18,528)	(11,084)
<b>Prime të shkruara neto</b>		<b>568,119</b>	<b>664,642</b>
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara	15	46,899	(34,777)
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit	15	2,728	1,066
<b>Të ardhura neto nga sigurimi</b>		<b>617,746</b>	<b>630,931</b>
Të ardhura nga interesi	20	47,617	49,557
Të ardhura të tjera		8,362	6,599
<b>Të ardhura neto</b>		<b>673,725</b>	<b>687,087</b>
Ndryshimi në rezervat e tjera matematikore	15	(50,934)	(61,276)
Humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	15	(131,223)	(87,237)
<b>Humbjet neto nga sigurim</b>		<b>(182,157)</b>	<b>(148,513)</b>
Shpenzimet e marrjes në sigurim	21	(246,671)	(235,469)
Shpenzime administrative	22	(78,096)	(49,382)
Shpenzime të tjera operative	23	(8,151)	(10,923)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>158,650</b>	<b>242,800</b>
Fitimi /Humbja nga kursi i këmbimit, neto		(11,298)	(12,225)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>147,352</b>	<b>230,575</b>
Tatimi mbi fitimin	24	(22,103)	(34,961)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>125,249</b>	<b>195,614</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>125,249</b>	<b>195,614</b>



**SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIASH.A.***(të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**

	Kapitali aksionar	Rezerva e sigurisë	Fitime të pashpërdara	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2015</b>	<b>370,000</b>	<b>150,749</b>	<b>123,427</b>	<b>644,176</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>				
Fitimi i vitit	-	-	195,614	195,614
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>			195,614	195,614
<b>Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital</b>				
Transferim i fitimit të pashpërdarë në rezervën e sigurisë	-	-	-	-
Dividend i paguar	-	-	(117,472)	(117,472)
<b>Totali i transaksioneve me pronarët</b>			<b>(117,472)</b>	<b>(117,472)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>370,000</b>	<b>150,749</b>	<b>201,569</b>	<b>722,318</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>				
Fitimi i vitit	-	-	125,249	125,249
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>			125,249	125,249
<b>Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital</b>				
Dividend i paguar	-	-	(195,614)	(195,614)
<b>Totali i transaksioneve me pronarët</b>			<b>(195,614)</b>	<b>(195,614)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>370,000</b>	<b>150,749</b>	<b>131,204</b>	<b>651,953</b>

Shënimet në faqet 5 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PAQYRA E FLUKSEVE TË PARASË**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Fluksi i parasë nga veprimtaritë operative</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>147,352</b>	<b>230,575</b>
<i>Rregullime për të barazuar fitimin neto me rrjedhën neto të parasë nga aktivitetet operative:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	14	1,919	1,787
Të ardhura nga interesi	20	(47,617)	(49,557)
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata		72	-
<b>Fluksi i parasë nga veprimtaritë operative përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>		<b>101,726</b>	<b>182,805</b>
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative:</i>			
Rënie/(ritje) në kosto të shtyra të marrjes në sigurim		58,284	(19,804)
Rënie/(ritje) në llogari të arkëtueshme nga sigurimi e të tjera		2,839	(3,873)
(Rritje) në aktive të risigurimit		(2,728)	(1,066)
Rënie/(ritje) në inventarë		106	(38)
Rritje në detyrimet për humbjen dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes		91,446	82,366
(Rënie)/ritje në rezervat për primin e pafitur		(46,899)	34,777
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme për risigurimin		175	482
(Rënie)/ritje në llogari të pagueshme për sigurimin e të tjera		(5,281)	3,495
<b>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative</b>		<b>97,942</b>	<b>96,339</b>
Tatim fitimi i paguar		(44,595)	(17,823)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti operacional</b>		<b>155,073</b>	<b>261,321</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese</b>			
Blerje aktive afatgjata materiale	14	(1,335)	(4,185)
Blerje aktive afatgjata jomateriale		-	(2,419)
Rënie/(ritje) në depozitat me afat		149,961	(175,954)
Rënie nga investimi në letra me vlerë		(408,103)	(720,604)
Rritje nga maturimi i investime në letra me vlerë		248,604	720,547
Interesa të marra		52,742	46,077
<b>Mjete monetare përdorur në veprimtaritë investuese</b>		<b>41,869</b>	<b>(136,538)</b>
<b>Fluksi i parasë nga veprimtaritë financuese</b>			
Dividendi i paguar	18	(195,614)	(117,472)
<b>Mjete monetare të përdorura në veprimtaritë e financimit</b>		<b>(195,614)</b>	<b>(117,472)</b>
<b>Rritje neto në mjete monetare</b>		<b>1,328</b>	<b>7,311</b>
<b>Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fillim të vitit</b>		<b>32,235</b>	<b>24,924</b>
<b>Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fund të vitit</b>	<b>8</b>	<b>33,563</b>	<b>32,235</b>

Shënimet në faqet 5 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.